# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur

Viti XXIV, nr. 7883

E shtunë, 14 shtator 2024

Çmimi 0. 50


## Ahmeti kërkon përshpejtimin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol

FAQE 6





Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# ÇKA THUHET NË AKTAKUZËN PËR BANJSKËN?

FAQE 4-5



Aktakuza që ngriti Prokuroria Speciale e Kosovës kundër 45 personave për sulmin e armatosur në Banjskë, i ngarkon shumicën e tyre për kryerje të terrorizmit dhe të veprave të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës

## OPINION

### KËRCËNIMET E SERBISË, MANOVRIME E TAKTIZIME QË S'DUHEN INJORUAR

F. 7

Shkruan:
Hajdin ABAZI



## AKTUALE



### MAQEDONCI FTON TË REJAT TË BËHEN PJESË E FSK-së

F. 3

### GJERMANIA KA MUNGESË TË PERSONELIT NË SISTEMIN E SHËRBIMIT MJEKËSOR

F. 2

### PËRDORIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE NË KOSOVË, TREND NË RRITJE

F. 7

## KOSOVA E UDHËHEQUR ME USHTRUES DETYRE

F. 3





## POLICIA SEKUESTRON TË HOLLA DHE DOKUMENTE NË OBJEKTE FINANCIARE NË LEPOSAVIQ

F. 7

## EKONOMI



### PSE CEFTA ËSHTË E RËNDËSISHME PËR KOSOVËN?

F. 8

### HAJDARI THOTË SE KA MBËSHTETJE E MADHE PËR BIZNESET QË FOKUSOHEN NË PRODHIMIN E GJELBËR

F. 8

## SPORT

### SUPERLIGA RIKTHEHET ME DY DERBI

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Harrisi zgjeron avantazhin përballë Trumpit

**Uashington, 13 shtator** - Sipas një anketimi të ri të opinionit publik, nënpresidentja demokrate Kamala Harris kryeson me 47 % mbështetje përkundër ish-presidentit republikan Donald Trump me 42 %, duke zgjeruar kështu më tej avantazhin e saj pas debatit televiziv ku votuesit mendojnë se Harrisi pati paraqitjen më të mirë.
Anketimi i bërë nga agjencia e lajmeve "Reuters" dhe firma e anketimeve "Ipsos" u publikua të enjten.
Anketimi dyditor tregon se Harris është në një avantazh prej 5 % ndër votuesit e regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet e këtij viti, duke zgjeruar kështu më tej avantazhin e saj prej 4 % përballë Trumpit sipas anketimit të mëparshëm që pati bërë agjencia "Reuters" dhe firma "Ipsos" në periudhën 21-28 gusht.
Ndër votuesit që thanë se patën dëgjuar të paktën diçka rreth debatit të së martës, Harris mori 53 % mbështetje, ndërsa 24 % prej tyre thanë se debatin e kishte fituar Trump. Rreth 52 % e të anketuarve thanë se Trumpi hasi në vështirësi dhe se nuk u shfaq në formën më të mirë, ndërsa 21 % prej tyre thanë të njëjtën gjë për Harrisin.
Nënpresidentja Harris, 59 vjeçe, e vendosi ish-presidentin Trump, 78 vjeç, në pozita mbrojtëse gjatë një debati të nxehtë presidencial, me një seri sulmesh ndaj përshtatshmërisë së tij për




detyrën e presidentit dhe sfidat e tij të shumta ligjore.
Anketimi përfshiu 1 690 amerikanë të moshës madhore në mbarë vendin, ndër ta 1 405 të regjistruar për të votuar këtë vit. Mundësia e gabimit të këtij anketimi është në nivelin rreth 3 % ndër votuesit e regjistruar.
Megjithëse anketimet në nivel kombëtar, përfshirë anketimin e bërë nga agjencia "Reuters" dhe firma "Ipsos", japin sinjale të rëndësishme për pikëpamjet e elektoratit, janë rezultatet shtet mbas shteti që certifikohen në Kolegjin Elektoral ato që përcaktojnë fituesin dhe pritet që rezultati përfundimtar të vendoset nga një numër i vogël shtetesh jetike për betejën elektorale.

# Rusia i dëbon gjashtë diplomatë britanikë



**Moskë, 13 shtator** - Shërbimi Federal i Sigurisë i Rusisë (FSB) i ka akuzuar gjashtë diplomatë britanikë për spiunazh dhe ka thënë se ka vendosur t'ua heqë atyre akreditimin.
Televizioni shtetëror rus e citoi një zyrtar të FSB-së të ketë thënë se ata do të dëbohen.
FSB-ja pretendon se mori dokumente që tregojnë se ata ishin dërguar në Rusi nga një divizion i Ministrisë së Jashtme britanike dhe se "detyra kryesore e tyre është shkaktimi i një disfate strategjike ndaj vendit tonë". Sipas saj, ata ishin përfshirë "në grumbullimin e të dhënave dhe në aktivitete armiqësore".
FSB-ja tha se Rusia do t'u kërkojë diplomatëve të tjerë britanikë të largohen më herët, nëse zbulon se janë të përfshirë në aktivitete të ngjashme.
Ky vendim u mori vetëm dy ditë pasi Shtetet e Bashkuara dhe Britania u zotuan se do ta ndihmojnë Ukrainën me 1.5 miliard dollarë shtesë, dhe pasi zyrtarët ukrainas i vazhduan kërkesat ndaj Perëndimit për përdorimin e raketave perëndimore për sulme thellë brenda Rusisë.
Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, u citua nga agjencia shtetërore e lajmeve TASS të ketë thënë se aktivitetet e Ambasadës së Britanisë në Moskë kanë "tejkaluar kufijtë" e konventës diplomatike, duke e akuzuar atë për aktivitete me qëllim për ta dëmtuar popullin rus.

# Gjermania ka mungesë të personelit në sistemin e shërbimit mjekësor

**Berlin, 13 shtator** - Gjermania përballet me një mungesë prej rreth 25 mijë profesionistësh të kujdesit shëndetësor. Qendra Spitalore e Rostockut ka krijuar modelin e suksesshëm të tërheqjes së stafit nga Vietnami.
Në Qendrën Mjekësore Universitare të Rostokut nga viti 2018 filluan të kërkojnë në Vietnam për punonjës. Qasja e kësaj qendre fokusohet edhe në ndihmën e anëtarëve të rinj të stafit jogjerman që të integrohen pa probleme.
Vietnamezja Thi Ngoc Lan Pham është një infermierie e kujdesit intensiv. Puna është intensive, por ajo përballet me sfidën shtesë të punës në gjermanisht; një gjuhë që asaj iu desh ta mësonte fillimisht.



Thi Ngoc Lan punon në Qendrën Mjekësore Universitare në Rostock prej gati pesë vitesh. Ajo përfundoi trajnimin e saj si infermiere këtu dhe tani angazhohet edhe si trajnere ndërkulturore për të sapoardhurit.
Thi Ngoc Lan ka bërë një rrugë të gjatë në ndjekjen e një të ardhmeje më të mirë. Gjermania nuk e njohu diplomën e saj të infermierisë nga Vietnami, ndaj iu desh të ndiqte sërish kurse kualifikimi këtu.
Çdo vit, deri në 25 të rinj nga Azia, kryesisht gra, marrin trajnime këtu. Ajo që është unike është se shumica qëndrojnë në Qendrën Mjekësore Universitare – kryesisht për shkak të programit të rikualifikimit të klinikës, i cili përfshin edhe rregullimin e strehimit, ndihmën me dokumentet dhe ofrimin e kurseve të gjermanishtes që mbulojnë fusha tipike të infermierisë.
Fokusi i rekrutimit të Rostock në Vietnam nuk është rastësi. Kur qyteti i përkiste ende Gjermanisë Lindore, deri në 1 500 vietnamezë jetonin këtu dhe quheshin "Vertragsarbeiter"
Thi Ngoc Lan Pham thotë se rrallëherë e merr malli [për Vietnamin]. Ajo ka krijuar shoqërinë e saj gjermane në punën e saj.
Thi Ngoc Lan Pham i ka mbushur tani plot pesë vjet në Gjermani, ku mund të aplikojë për shtetësinë gjermane. Plani i saj është të qëndrojë këtu dhe të sjellë të dashurin e saj nga Vietnami./DW/

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kosova e udhëhequr me ushtrues detyre

**Prishtinë, 13 shtator** - Për më shumë se tri vjet të qeverisjes Kurti 2, shumë institucione të rëndësishme vazhdojnë të drejtohen me ushtrues detyre. Për këtë, kritika ndaj qeverisë kanë adresuar partitë opozitare dhe shoqëria civile.
Mosemërimi në pozita udhëheqëse është duke u parë si praktikë që partia në pushtet po e përdor që të ketë kontroll më të lehtë në institucione, por edhe për "rehatimin" e bashkëpartiakëve.
Kryeprokurori i Shtetit, ndërmarrja publike "Trepça", Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia për Menaxhim Emergjent, Instituti i Mjekësisë Ligjore, e shumë agjenci dhe ndërmarrje të tjera publike po udhëhiqen nga ushtrues detyre.
Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rashit Qalaj, ka thënë se ekzekutivi i ka dëmtuar institucionet e Kosovës duke i lënë të udhëhiqen me ushtrues detyre. Sipas Qalajt, edhe kjo qeveri duhet sa më shpejt të jetë me ushtrues detyre. "Qeveria e Kosovës ka arritur të instalojë dhe mendojë që është shumë e dëmshme për institucionet e Kosovës. Ushtrimi i detyrës për një kohë të gjatë fillimisht është i kundërligjshëm dhe e dyta personi i cili është me ushtrues detyre nuk i jep të gjitha autorizimet për punën e tij në ato institucione. Dhe duke pasur parasysh që shumica e institucioneve të rëndësishme, duke filluar nga kryeprokurori i shtetit e tutje janë me ushtrues, mendoj që sa më shpejt edhe kjo qeveri të jetë me ushtrues detyre dhe ta zëvendësoj me një qeveri tjetër për shkak se është duke u bërë dëm shumë institucioneve, është duke shkatërruar shumicën e institucioneve dhe është duke tentuar t'i dëmtojë ato, sidomos tani që është edhe koha e zgjedhjeve, po e shoh dhe po e vërej që numri i institucioneve me ushtrues detyre po rritet", ka thënë Qalaj.
Ndërsa deputeti tjetër opozitar nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, është shprehur se qeveria Kurti po i lë pozitat kyçe të institucioneve me ushtrues detyre me qëllim të interferojë politikisht në punën e tyre. "Duke filluar prej organeve të drejtësisë, nëpër agjenci të ndryshme, mendoj se kjo është një formë për të interferuar politikisht në punën e atyre institucioneve, shumë prej tyre të pavarura në aspektin kushtetues", thotë Hoti.
Mendim të njëjtë ka edhe drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, i cili ka nënvizuar se kjo qeveri po e vazhdon avazin e qeverisjeve të kaluar sa iu përket pozitave që ushtrohen me ushtrues detyre.



Miftaraj ka vlerësuar se kjo praktikë po përdoret me qëllim të kontrollimit më të lehtë nga ana e ekzekutivit ndaj këtyre ndërmarrjeve dhe agjencive shtetërore. "Edhe kjo qeveri po vazhdon avazin e qeverive të kaluara nëse marrim shembull drejtorin e Njësisë së Inteligjencës Financiare, është me ushtrues detyre prej që ka ardhur kjo qeveri 4, 3 vjet me ushtrues detyre ka edhe shumë e shumë pozita të tjera. Kjo do të thotë e ka vetëm një qëllim të vetëm që personat që janë të caktuar në këto pozita janë më lehtë të kontrollueshëm… Është mënyrë e mirë e kontrollimit dhe nuk ka shumë kërkesa për të arritur rezultate, performancë të këtyre personave sepse këta janë ushtrues detyre, mund të qëndrojnë 6 muaj, 1 vit dhe pas 1 viti, mund të ndërrohen. Por, pastaj kur qeveria me mosveprim ua zgjat mandatin me 3 e 4 vjet", ka thënë Miftaraj.
Ushtrimi i pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre po kritikohet edhe nga njohësit e ekonomisë. Konsiderohet se si rezultat i kësaj politike po mungojnë edhe sukseset, sidomos në ndërmarrjet publike.
Analisti i çështjeve ekonomike, Adem Qorolli, ka thënë se institucionet e vendit po i përdorin si trampolinë fuqinë politike të tyre në sistemin e bordeve. "Institucionet e vendit po i përdorin si trampolinë fuqinë politike të tyre në sistemin e bordeve. Kjo politikë është përdorur nga viti 2000 dhe nuk është ndërprerë më dhe ky është suksesi maksimal i ndërmarrjeve publike, ku gjithmonë sukseset i kanë bartur në donacionet e shtetit apo subvencionet shtetërore sepse nuk ia kanë arritur t'i mbijetojnë me politika. Kurse gabimi i dytë është me ushtrues detyre ku çdo ndërmarrje publike në Kosovë, është duke e shkelur pjesën ligjore", ka thënë Qorolli.
Ai ka këshilluar që politika sa më shpejt të heqë dorë nga emërimet politike, sidomos në ndërmarrjet ekonomike të vendit. "Ngopja e dëshirave të tyre apo rehatia e personave politikë janë pasqyrimi më i mirë i bordeve. Suksesi i institucioneve shihet në ndërmarrjet publike dhe këtë fat e kanë pasur qysh më herët dhe tashmë po shfrytëzohet edhe tash. Sa më shpejt që institucionet heqin dorë nga institucionet politike aq më shpejt do të kemi edhe suksese në ndërmarrjet publike… Shkaktari është politik që nuk e lë atë ndërmarrje të marrë frymë nga personat adekuatë, ose edhe nëse është personi adekuat e lë si ushtrues detyre që ta mbajë pezull në mbushjen e apetiteve politike me njerëz që ka aty që të mbushë ndërmarrje me militant apo aktorë politikë", ka thënë Qorolli. /KP

# Ahmeti kërkon përshpejtimin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol




**Prishtinë, 13 shtator** - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmeti, ka thënë se duhet të përshpejtohet rruga drejt anëtarësimit të Kosovës në organizatën më të madhe të policisë globale, Interpol, pasi arrestimet e ish-ushtarëve të UÇK-së me fletarrestim nga Serbia, janë të shpeshta.
Duke folur për arrestimin e Blerim Ramadanit nga Policia e Maqedonisë së Veriut më 17 korrik në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Serbia, Ahmeti ka thënë për "EO" se Serbia do të vazhdojë t'i mbajë nën presion ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). "Kjo është një çështje që duhet parë me komunitetin ndërkombëtar që të përshpejtohet rruga drejte anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Përndryshe pa anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe pa një marrëveshje bashkë me komunitetin ndërkombëtar, në këtë rast me BE-në dhe ShBA, Serbia do të vazhdojë t'i mbajë në presion të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjithë aktivistët. Listat janë plot e përplot me aktivistë të anti-pushtuesit dhe kjo çështje duhet të merret me seriozitetin më të madh", ka thënë Ahmeti, teksa ka arsyetuar veprimin e policisë maqedonase për arrestimin e ish-ushtarit të UÇK-së. "Çështja është se vendimet merren. Interpoli ekzekuton vendimet që marrin shtetet anëtare të Interpolit, Maqedonia e Veriut është anëtare e Interpolit, Shqipëria është anëtare e Interpolit dhe kanë obligime t'i respektojnë vendimet e shteteve pjesëtare të Interpolit", ka thënë ai.
Blerim Ramadani është ndaluar më 17 korrik 2024 në pikëkalimin kufitar Jazhincë, bazuar në një fletarrestim të lëshuar nga Gjykata e Beogradit, përmes INTERPOL Serbia, me pretendimin për krime lufte në verën e vitit 1999 në rajonin e Nerodimës.
Ky nuk është rasti i vetëm kur autoritetet e Maqedonisë së Veriut arrestojnë ish-ushtarë të UÇK-së për shkak të fletarrestimeve nga Serbia.
Në vitin 2016, pikërisht për shkak të fletarrestimit nga Serbia, ishte arrestuar në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, Gafurr Elshani.

## Maqedonci fton të rejat të bëhen pjesë e FSK-së

**Prishtinë, 13 shtator** - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, u ka bërë thirrje të rejave të aplikojnë për t'u bërë ushtare të FSK-së. Nëpërmjet një videoje të postuar në "Facebook", ai ka thënë se beson thellësisht se si burrat, edhe vajzat e gratë e duan atdheun dhe janë në gjendje të luftojnë e të vdesin për të. "Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë multietnike, me element përbashkues vullnetin për t'i shërbyer atdheut, përtej dallimeve gjinore e kulturore është forcë për të qëndruar gjithmonë stoik në mbrojtje të sovranitetit territorial e të jetës së qytetarëve. Ne besojmë thellësisht se si burrat, edhe vajzat e gratë e duan atdheun dhe janë në gjendje të luftojnë e vdesin për të, siç e kanë dëshmuar fuqishëm në të gjitha periudhat e historisë sonë të lavdishme. Andaj, ftoj të rejat që të aplikojnë për tu bërë ushtare të FSK-së, si forma më fisnike për t'i shërbyer Kosovës", ka shkruar Maqedonci.





# Çfarë thuhet në aktakuzën për Banjskën?

**Aktakuza që ngriti Prokuroria Speciale e Kosovës kundër 45 personave për sulmin e armatosur në Banjskë i ngarkon shumicën e tyre për kryerje të terrorizmit dhe të veprave të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës**

**Prishtinë, 13 shtator** - Aktakuza që ngriti Prokuroria Speciale e Kosovës kundër 45 personave për sulmin e armatosur në Banjskë i ngarkon shumicën e tyre për kryerje të terrorizmit dhe të veprave të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës.

Sipas dokumentit prej 158 faqesh që siguroi "Radio Evropa e Lirë", Millan Radoiçiq ngarkohet edhe me lehtësim dhe financim të kryerjes së terrorizmit dhe shpëlarje të parave, ndërsa Radulle Steviq dhe personi juridik RAD D.O.O. vetëm me shpëlarje të parave.

Në aktakuzë thuhet se ky grup, përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, ka tentuar "ta shkëpusë pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe, dhe këtë pjesë të territorit t'ia bashkojë Republikës së Serbisë".

Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi për ngritjen e aktakuzës më 11 shtator, gati një vit pas sulmit në Banjskë.

Në këtë fshat në veri të Kosovës, një grup i armatosur serbësh sulmoi Policinë e Kosovës më 24 shtator 2023, duke vrarë policin Afrim Bunjaku.

Në përleshjet e armatosura që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Në aktakuzë, Prokuroria përmend 34 dosje me prova, në mesin e të cilave ka video-incizime, analiza të pajisjeve elektronike, përgjigje të ndryshme nga Luksemburgu, Bosnjë-Hercegovina, bankat dhe institucione të ndryshme, deklarata të dëshmitarëve etj.

## Si përshkruhet sulmi në aktakuzë?

Në aktakuzë, Millan Radoiçiq cilësohet si "kreu i grupit terrorist", i cili bashkë me pjesëmarrësit e tjerë, më 24 shtator 2023, në orën 01:00, pasi që kanë bllokuar rrugën tek ura e fshatit me dy kamionë dhe pastaj janë fshehur, kanë sulmuar zyrtarët policorë të Kosovës, të cilët kanë shkuar për t'i hequr kamionët dhe për të liruar rrugën.

Me këtë rast është vrarë zyrtari policor, Afrim Bunjaku, është plagosur zyrtari policor Alban Rashiti dhe janë lënduar zyrtarët e tjerë policorë: Çlirim Shaqiri, Mirsad Kryeziu, Sedat Dushi.

Ky sulm, sipas aktakuzës, ka vazhduar deri në orën 15:00, "kur shumica dërrmuese e këtij grupi është arratisur në drejtim të rrugëve malore për në Republikën e Serbisë".

Në aktakuzë thuhet se ata kanë qenë "të trajnuar në mënyrë profesionale" dhe se kanë hyrë ilegalisht në Kosovë nga Serbia "përmes rrugëve malore" dhe me dhjetëra vetura, "disa prej tyre të blinduara dhe të mbushura me armë të rënda, municion, raketahedhës, eksplozivë, uniforma të kamufluara ushtarake dhe pajisje logjistike ushtarake".

Sipas aktakuzës, nga 1 janari i vitit 2017 deri më 24 shtator 2023, kur ka ndodhur sulmi në Banjskë, Millan Radoiçiq ka siguruar të ardhura në mënyrë të tërthortë, pjesa më e madhe e të cilave janë përdorur për armatim të rëndë, uniforma ushtarake, mbështetje logjistike dhe pagesën e pjesëmarrësve të grupit.

Në aktakuzë thuhet se një pjesë e të hyrave të tij buron nga "aktiviteti kriminal, përmes bashkëpunimit dhe ndihmës së të pandehurit Radulle Steviq - pronar dhe person përgjegjës i bizneseve RAD D.O.O. dhe Radulle Steviq B.I".

Sipas aktakuzës, ai i ka konvertuar paratë në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndërsa një pjesë të pasurive të paluajtshme e ka transferuar edhe te personat e tretë, me qëllim të fshehjes ose maskimit të burimit të pasurisë.

## Çfarë thonë të pandehurit që janë në paraburgim?

Prej të pandehurve që përfshin aktakuza, tre janë në paraburgim në Kosovë: Vlladimir Tolliq, Bllagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviq.

Sipas aktakuzës, një i pandehur është mbrojtur në heshtje.

Një tjetër ka deklaruar në Stacionin policor të Mitrovicës më 24 shtator 2023, se një ditë më herët ka shkuar në Rashkë, ku është takuar me tre persona (po ashtu të akuzuar), me të cilët, në mënyrë të organizuar me disa vetura, kanë shkuar në Banjskë, ku u janë dhënë uniforma dhe armatim.

Atij i është thënë se "do të bëhet një barrikadë me kamion dhe një protestë, për të cilën ka menduar se është paqësore". "Por, pasi ka pranuar uniformën ushtarake-taktike dhe armatimin, aty e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull, por se është detyruar t'u bindet urdhrave", thuhet në aktakuzë. Sipas aktakuzës, ai ka thënë se gjatë natës ka qëndruar në një veturë dhe pastaj në afërsi të një ujëvare dhe në mal, dhe se "asnjëherë nuk ka shtënë me armë".

Më vonë ai i është dorëzuar Policisë së Kosovës.

Ai, po ashtu, ka deklaruar se rreth dhjetë vetura të tipit Jeep pa targa kanë ardhur nga Serbia me rreth 50 persona, shumicën e të cilëve ka thënë se nuk i ka njohur.







"Gjithashtu, ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë presion apo kërcënim për të marrë pjesë në këtë grup dhe se vullnetarisht është bërë pjesë e tij...".

### Çfarë thonë dëshmitarët?

Në aktakuzën e ngritur përmenden gjithsej 29 dëshmitarë - tre prej të cilëve janë anonimë. Në mesin e dëshmitarëve është edhe Ema Rexhepagiq, bashkëshortja e Radoiçiqit.
Përveç pjesëtarëve policorë që ishin në detyrë gjatë sulmit, dëshmitarët e tjerë përfshijnë edhe mysafirë dhe punëtorë të hotelit dhe banjës termale "Rajska Banjska" në fshatin Banjskë, si dhe persona që njohin të përfshirë në sulm.
Një dëshmitar i mbrojtur me nofkën F1 ka deklaruar se një mik i tij i ngushtë ka qenë pjesë e sulmit dhe se këtë e ka kuptuar pasi ai e ka telefonuar nga Serbia, pas sulmit.
Sipas aktakuzës, ai ka deklaruar se miku i tij i ka thënë që "celula ka filluar nga organizata Mbrojtja civile (Civilna Zastita), ku këta persona janë organizuar me qëllim që të krijojnë strukturë paralele me institucionet e Kosovës". Sipas tij, Millan Radoiçiqi i ka organizuar këta persona, "të cilët i ka ushtruar, i ka përgatitur me armatim të lehtë dhe të rëndë". Po ashtu, "për një kohë të gjatë ata kanë ushtruar në Serbi" dhe "shumicën prej tyre Millani i ka paguar nga 2 000 euro në muaj, përmes parave kesh, për t'i përfshirë në këtë grup".
Qëllimi i sulmit, sipas këtij dëshmitari, ka qenë "çlirimi i pjesës veriore të Kosovës" dhe që "serbët e kësaj pjese të shkëputeshin nga Kosova".
"Pastaj, një natë përpara sulmit, Millani i ka thirrur në takim dhe ata kanë hyrë në po të njëjtën natë, para agimit, diku rreth orës 03:00 të mëngjesit, dhe nga aty ka filluar sulmi", thuhet në aktakuzë.
Ky dëshmitar, po ashtu, ka dëshmuar se miku i tij i ka thënë se armatimin e kanë marrë në Serbi dhe se atë e ka siguruar Radoiçiq, "me lidhje të forta përmes shtetit të Serbisë",
Ky dëshmitar, sipas aktakuzës, përmend edhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe




"njerëzit e tij" si të përfshirë, por pa shumë detaje konkrete.
Më tutje, dëshmitari anonim, i emëruar A2, ka rrëfyer se po kalonte në zonën ndërmjet kufirit të Serbisë dhe Kosovës, ku vëzhgoi lëvizje të shumta të automjeteve dhe personave të dyshimtë, përfshirë edhe automjete pa targa dhe me targa serbe. "Ishte ditë e diel kur rreth orës 09:00 të mëngjesit ka ecur kodrave të kufirit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe, rreth orës 10:00, kishte shkuar në Rogozna, që është 500 metra deri në 1 km larg nga kufiri i Kosovës", thuhet në aktakuzë. "Ai identifikoi rreth 15 meshkuj të veshur me uniforma të gjelbra dhe të lagur nga shiu, të cilët ishin kthyer nga Banjska pas sulmit dhe atje priteshin nga gratë e tyre, motrat dhe anëtarët e tjerë të familjes", thuhet, po ashtu, në aktakuzë.
Duke mos dashur të kalojë pranë tyre, ai i kishte anashkaluar dhe "ishte ngjitur në një kodër, ku ka parë gjithë kufirin dhe shumë pjesë të territorit të Kosovës". "Prej aty ka parë që shumë prej tyre vinin nga Manastiri i Banjskës dhe se në kthim i prisnin dy automjete të zeza të markës Dacia, të cilat po vinin në drejtim të tyre dhe ishin të pista dhe të lagura nga shiu". "Këto dy vetura normalisht kalonin nga policia serbe pa asnjë kontroll dhe ndalim, lëviznin vazhdimisht deri në dy ose tri herë, duke transferuar anëtarët e atij grupi", citohet dëshmia e dëshmitarit A2 në aktakuzë.
Ky dëshmitar i ka thënë Prokurorisë se beson që ai grup "është furnizuar me armatim dhe pajisje personalisht nga Serbia, nga duart e privatëve, sepse armët blihen lehtë në Serbi - 200-300 euro mund të blesh një kallashnikov".
Dëshmitarë të tjerë, ndërkaq, kanë deklaruar se çfarë kanë parë dhe dëgjuar jashtë mureve të hotelit "Rajska Banjska", ku po qëndronin atë natë.
Në dëshmitë e tyre ata kanë thënë se kanë dëgjuar krisma të mëdha për orë të tëra natën e 24 shtatorit dhe se për një periudhë të caktuar nuk kanë mundur të largohen nga hoteli.
Sipas dëshmisë së dëshmitarit G.T., mysafir në këtë hotel gjatë asaj nate - kur kanë filluar të shtënat, ai ka parë dy apo tre persona, ndërsa pastaj hoteli është mbushur plot. Sipas dëshmisë së tij, persona të armatosur dhe me uniforma kanë urdhëruar që ata të mos largoheshin nga hoteli dhe gjatë gjithë kësaj kohe "kanë mbetur pa ushqime dhe pa ujë".

### Dëshmitë e kolegëve të Afrim Bunjakut

Në aktakuzë përshkruhet në detaje ngjarja se si erdhi deri te vrasja e rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku.
Tetë pjesëtarë të Policisë së Kosovës, të cilët kishin arritur të parët në Banjskë, kanë shpjeguar në dëshmitë e tyre se si rreth orës 02:00 të mëngjesit të 24 shtatorit 2023, kishin vërejtur bllokimin e rrugës në hyrje të fshatit Banjskë.
Pjesëtari i Policisë së Kosovës, Alban Rashiti, ka treguar se kamionët e vendosur në mes të rrugës, i kishin vërejtur në kohën kur po ktheheshin nga pika kufitare në Izvor.
Pasi kishin parë kamionët, Rashiti dhe kolegët e tij kanë thënë se janë udhëzuar që të kontrollojnë edhe rrugë të tjera për të parë nëse ishin vendosur bllokada.
Pas këtij momenti, drejt Banjskës ishin dërguar njësi të tjera nga stacioni policor i Zveçanit. "Dhoma komanduese i ka informuar që ka dërguar njësi shtesë për të ardhur në vendin e ngjarjes dhe, po ashtu, atyre u është thënë që të kthehen dhe të qëndrojnë në lokacion dhe të bëjnë foto të kamionëve, të cilët kanë bllokuar rrugën dhe t'ua dërgojnë", thuhet në aktakuzë.
Pas rreth 20 minutash, aty kanë arritur njësi shtesë, e në njërën prej veturave ishte edhe rreshteri Afrim Bunjaku.
Bunjaku dhe një koleg tjetër ishin nisur drejt kamionëve që bllokonin rrugën dhe papritmas kishte ndodhur një shpërthim. "Në ato momente ka vërejtur që rreshteri (Afrim Bunjaku) ka mbetur i shtrirë në tokë", thuhet në aktakuzë.
Pjesëtari tjetër i Policisë së Kosovës, Çlirim Shaqiri, ka deklaruar se si ishte munduar që ta tërhiqte nga vendi i ngjarjes rreshterin Afrim Bunjaku pas plagosjes.
"Është afruar tek ai dhe e ka vërejtur se plagët e tij janë në fyt dhe ka gjakderdhje", por e kishte të pamundur ta tërhiqte, thuhet në aktakuzë.
"Ai kishte provuar sërish ta kryente tërheqjen, kësaj here përmes veturës... Sulmuesit me armë kanë shtënë në drejtim të tij dhe kanë arritur ta godasin veturën e cila është fikur... Ka mbetur brenda në veturë, pasi nuk ka mundur të dilte prej saj nga të shtënat e shumta në drejtim të tij", përshkruan aktakuza momentin e sulmit.
Bunjaku ishte tërhequr më pas përmes një veture tjetër dhe ishte dërguar drejt Mitrovicës së Jugut.
Duke qenë në numër të ulët dhe duke parë artilerinë e rëndë që po i sulmonte, policët kishin provuar të tërhiqeshin nga sulmi, por në ato momente atyre iu kanë ardhur përforcime, përfshirë automjete të blinduara, sipas aktakuzës.
Aty thuhet se konfrontimet kanë zgjatur disa orë dhe se zyrtarët policorë të Kosovës e kanë pasur të mundur t'i përgjigjen sulmit efektivisht deri në fund, pas ardhjes së njësive shtesë.
Në fund të aktakuzës, prokurori i rastit, Naim Abazi, thotë se për shkak të rrezikshmërisë së madhe dhe pasojave, të cilat mund t'i shkaktojnë veprat e kryera penale, "në legjislacionin tonë janë paraparë dënime shumë të rënda, për çka, me rastin e matjes së dënimit kundër të pandehurve, i propozojmë gjykatës që t'i marrë parasysh".

### Kush janë të pandehurit?

Në aktakuzë përmenden 45 persona: Millan Radoiçiq, Bllagoje Spasojeviq, Vlladimir Tolliq, Dushan Maksimoviq, Vlladimir Radivojeviq, Uglesa Jarediq, Millorad Jevtiq, Vllastimir Andriq, Aleksandar Millosavleviq, Llazar Shmigiq, Velko Gjorgjeviq, Vlladimir Vuçetiq, Stefan Jovanoviq, Millovan Kërstoviq, Urosh Milliq, Trajko Vasiq, Danillo Vasiq, Vukashin Jarediq, Sasha Periq, Nemanja Stankoviq, Momçillo Vuçkoviq, Stefan Radojkoviq, Marjan Radojeviq, Marko Arsiq, Zharko Cvetkoviq, Kërsto Damjanoviq, Stefan Millosavleviq, Marko Saviq, Aleksandar Jevremoviq, Radosh Gvozdiq, Ivan Milliq, Gojko Zubaq, Nemanja Radivojeviq, Radak Axhiq, Millosh Millenkoviq, Gjorgje Balloviq, Danijell Gjukiq, Danillo Virijeviq, Aleksandar Tanaskoviq, Millosh Kragoviq, Milan Nedelkoviq, Nikolla Illiq, Vlladan Illiq, RAD D.O.O. dhe Radulle Steviq.

# PDK-ja: Kosova ka nevojë për qeveri dhe kryeministër të ri më 9 shkurt, Bedri Hamza është zgjidhja

**Prishtinë, 13 shtator** - Partia Demokratike e Kosovës ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës të Kryesisë, në të cilën është diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend.
Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se nisur nga situata e vështirë në të cilën gjenden sot Kosova dhe qytetarët tanë, mobilizimi për t'i dhënë vendit një qeveri të re, kredibile, të aftë dhe të përgjegjshme më 9 shkurt, është i domosdoshëm. Kryetari Krasniqi i ka njoftuar anëtarët e kryesisë me të gjitha përgatitjet që po bëhen në mobilizimin e të gjitha strukturave të partisë brenda dhe jashtë Kosovës.
Ndërsa kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka njoftuar anëtarët e Kryesisë me punën që është bërë në përpilimin e programit dhe ofertës së PDK-së për zgjedhjet e 9 shkurtit. Hamza ka thënë se PDK-ja do ta ketë programin më të mirë dhe më profesional - pikërisht atë për të cilin kanë nevojë sot vendi dhe qytetarët.
Anëtarët e Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës i kanë dhënë mbështetjen e plotë kandidatit për kryeministër, Bedri Hamza, në raport me punën dhe programin e tij qeverisës. "Partia Demokratike e Kosovës më 9 shkurt të vitit 2025, në zgjedhjet e reja parlamentare në vend, përmes kandidatit të saj Bedri Hamza, ofertës së tij programore dhe listës së kandidatëve për deputetë, do t'i jap vendit një qeveri të re që rikthen shtetin në rrugën e zhvillimit dhe integrimit euroatlantik", ka njoftuar PDK-ja.



# Kërcënimet e Serbisë, manovrime dhe taktizime që s'duhen injoruar




Shkruan: Hajdin ABAZI

Shovinizmi serb në krye me Vuçiq i ngjan personave me energji vet-gjeneruese negative, që, edhe kur e dinë se vetë janë fajtorë, sikurse e di saktë politika e Vuçiqit, për konsekuencat e një veprim apo qëndrimi të bërë kokë më vete dhe pa llogaritur edhe rrjedhojat potenciale, nuk resht së vepruari për të kërcënuar, shantazhuar, shpifur, njollosur, etiketuar, shtrembëruar të vërtetën, e ndonjëherë edhe duke vepruar në drejtim të objektivit për ta intimiduar e mundësisht edhe për ta cenuar, por pa lënë gjurmë që të mos kapet. Kjo është definitivisht një gjendje patologjike, e cila rigjenerohet nga urrejtja dhe lakmitë aspak realiste - sepse historia nuk kthehet dot pas, askush nuk mundet ta kthejë kohën në një periudhë të caktuar të dëshiruar që të veprojë ndryshe dhe e vetja sjellje sado pak normale është pajtimi me realitetin; në vend të kësaj, një patogjen sillet herë duke lozur rolin e viktimës e herë të agresorit, dhe nuk resht që nuk resht duke e kontaminuar ambientin derisa të bëhet alverziv për receptorët, sa që i shmangen, për mos t'u infektuar nga qasja anakronike, absurde, degjenerative. Shmangia nga kontakti i tillë është shenja e parë e largimit nga sfera emocionale e patogjenëve, për ta ruajtur shëndetin mental personal. Një sjellje e tillë nuk po ndodhë ndaj Serbisë, madje e kundërta: çka po tregon me këtë perëndimi, se është imun ndaj patologjisë shoviniste serbomadhe, apo po e nonshalon, kjo mbetet të shihet.

Sa më shumë që Vuçiq bën veprime destruktive, devijuese dhe kërcënuese ndaj perëndimit, perëndimorët duket sikur aq më shumë i vardisen, për ta joshur, për ta mbajtur në orbitën ekzistuese të paktën, që të mos ofrohet edhe më shumë me Rusinë dhe Kinën, dhe në këtë kuadër jo vetëm mbyllin shpesh sytë ndaj tij, por edhe i bëjnë koncesione. Dhe politikisht ai vepron në disa drejtime njëherësh: në njërën anë forcon bashkëpunimin me Rusinë, pa e dënuar fare agresionin e saj në Ukrainë si qëndrim gjeopolitik perëndimor, dhe po ashtu edhe me Kinën, sa që bëri të njohur një marifet: patrullimin e përbashkët të forcave policore serbo-kineze në Serbi. Patrullimi i përbashkët i forcave policore të dy vendeve të kontinentit, mundësisht nga BE, është një proces integrues evropian, që synon t'i tejkalojë kufijtë nacional shtetëror drejt atyre kontinental. Por çfarë është patrullimi i përbashkët me forcat policore kineze? Nuk do të ishte befasi të iniciohej edhe patrullimi i përbashkët policor serbo-rus! Madje, në trendin aktual, nuk duhet përjashtuar mundësia edhe e patrullimit të tillë me Korenë e Veriut.

Kur Vuçiq e shpalli "botën serbe" nga shumëkush, me sa duket edhe në perëndim, u quajt thjesht vetëm si propagandë, si ornament, sa për të joshur elektoratin, por duket se nuk ishte vetëm e tillë, po shumë më tepër se aq: ishte një program shovinist serbomadh, që në emër të gjoja shpëtimit serb, të legalizojë dhe legjitimojë aspiratat serbomëdha ndaj popujve të tjerë fqinj. Ndonëse historikisht dihet se serbët janë dyndur në Ballkan në fund të shekullit VI të erës së re, pra afërsisht para 15 shekujsh, dhe përhapjen e serbëve në trevat ku ata ndodhen sot e kanë bërë përmes luftërash të përgjakshme invaduese, programesh e elaboratesh për kolonizimin e trevave të atdheut shqiptar, edhe për ta përvetësuar atë e edhe për t'i dëmtuar territorialisht dhe substancialisht shqiptarët, Beogradi zyrtar vazhdon të propagandojë ndjekjen e përndjekjen e serbëve nga shqiptarët, edhe pse kjo është krejt e pavërtetë. Madje, këtë vazhdon ta bëjë çdo ditë edhe pse sigurinë e ka në përgjegjësi KFOR-i, dhe ata dëshmojnë se nuk po ndodhë një proces i tillë realisht në Kosovë, se është një trillim i Vuçiqit e i pushtetit të tij. Por kjo është, megjithatë, e rrezikshme: tashmë u denoncua plani i Beogradit zyrtar për inseminimin e gjoja shpërnguljeve serbe nga Kosova nga përndjekjet e pushtetit aktual, madje u pohua se edhe ka ndërtuar objekte banimi në Sanxhak, ashtu që atje t'i zhvendos serbët e Kosovës, për të krijuar imazhin e një "eksodusi biblik" serb.

Aq sa po vërehet nga qasja publike, duket se Qeveria e Kosovës nuk po i kushton ndonjë vëmendje të duhur këtyre paralajmërimeve, por mbetet për t'u besuar se organet e sigurisë, para së gjithash AKI-ja, policia e FSK-ja dhe KFOR-i t'i kenë parasysh dhe të kundërveprojnë, për ta neutralizuar dhe pamundësuar një veprim të tillë me pretendim për ta paraqitur pushtetin e Kosovës gjoja njëlloj si pushteti i Millosheviçit, i cili me ushtri e polici i dëbonte shqiptarët nga atdheu i tyre, efekti i së cilës do të ishte një furi anti-Kosovë, për ta damkosur imazhin diplomatik edhe të Kosovës e edhe të Perëndimit. Lista Serbe nxitoi t'i ankohet shefit të ri të BE-së në Kosovë se "Populli serb çdo ditë vuan nga represioni i regjimit të Albin Kurtit, qëllimi i dukshëm i të cilit është dëbimi i popullit serb nga këto vise". Kështu, Lista serbe vazhdon të jetë e instrumentalizuar nga Vuçiq, duke shtrembëruar të vërtetën dhe realitetin: jo vetëm që serbët nuk kanë asnjë represion si qytetarë dhe vetëm pse janë serbë - ashtu sikurse kishin shqiptarët nën regjimin e Millosheviqit, por madje edhe kriminelët ndiqen me kujdes dhe në koordinim më KFOR-in e EULEX-in, të cilët edhe janë mbikëqyrës e edhe dëshmitarë. Sa herë që ndonjë kriminel serb është arrestuar, Vuçiq dhe pushteti i tij kanë gënjyer se po arrestohen serbët; në Kosovë nuk ka asnjë rast që ndonjë qytetar është arrestuar vetëm për shkak të përkatësisë etnike, e pra as dhe një serb i vetëm nuk është arrestuar vetëm pse është serb. Kriminelët po, janë arrestuar dhe do të arrestohen edhe në të ardhmen pavarësisht se a janë shqiptarë, serbë apo të ndonjë përkatësie tjetër etnike. Kosova kurrë nuk ka arrestuar pleq, plaka, burra e gra, të rinj e fëmijë vetëm pse janë serbë; një Kosovë e tillë, një regjim që do të mund ta bënte këtë, nuk do të ishte i dalë nga vullneti i popullit shqiptar për bashkëjetesë, paqe, harmoni, respekt të ndërsjellë, stabilitet dhe siguri; një Kosovë e tillë dhe një pushtet i tillë, para se gjithash, nuk do të ishte i imi, pra nuk do të më përfaqësonte mua as si qytetar, as si ish-i-burgosur politik, as si ish-UÇKist e as si politikanë shtetndërtues në Kosovë për rreth dy dekada e gjysmë pas përfundimit të luftës.

Ngritja e aktakuzës ndaj grupit agresionist në krye me Radojçiqin duket se ka trazuar thellë Vuçiqin dhe pushtetin e tij në Beograd, pasi që ajo u ngrit me kontributin e SHBA dhe të BE, e që me sa duket do të nxirret në pah involvim i Beogradit zyrtar në atë ndërmarrje invaduese, gjë që po bëhet përpjekje për ta shantazhuar Perëndimin me dërgimin e Vulinit te Putini dhe të forcimit të bashkëpunimit me Kinën përgjithësisht e posaçërisht me sjelljen e një kontingjenti forcash policore kineze në Serbi për gjoja patrullim të përbashkët! Po bëhet një lojë e shumëfishtë në gjeopolitikë, duke manovruar midis gjeostrategjive dhe gjeotaktikave, duke trumbetuar edhe participimin e Serbisë në BRICS - në bllokun antiamerikan dhe anievropian, në situatën e nderë të BE nga lufta invaduese ruse në Ukrainë dhe rreziku i përhapjes së saj edhe në treva të tjerë të kontinentit e para se gjithash në Ballkan nga Serbia dhe përmes saj, por edhe nga kërcënimet ruse për luftë bërthamore.

Perëndimi sigurisht se i përcjellë në detaje lëvizjet, sjelljet, veprimet, manovrat, taktizimet e luftën psikologjike hibride, dhe sikur bëhet një luftë e nervave se kush do të mundet të qëndrojë deri në fund, por nuk duhet harruar se shovinizmi serb e ka përhapur gjithandej helmin e vet ndër breza dhe energjia e saj negative e urrejtjes dhe e lakmisë për ekspansion dhe invadim është e pafund, nuk ka të ndalur ndryshe përpos veprimit me të njëjtat metoda e qasje. Në këtë spektër të gjerë të gjeopolitikës duket se popujt rajonalë, si shqiptarët, boshnjakët e malazezët janë ata që do të paguajnë koston e sjelljes vardisëse të perëndimit. Me siguri, të gjitha këto, dhe shumë të tjera, janë kalkuluar. Por, sikurse e kam theksuar edhe më parë, të gjitha këto janë minore, krahasuar me rrezikun potencial qe Serbia të bëhet një bastion rus dhe vija ndarëse midis perëndimit dhe Rusisë të bëhej Serbia. Parandalimi i kësaj është në interesin e të gjithëve dhe të gjithët duket të kontribuojnë, pa dëmtuar interesin nacional, por më bashkërendim me SHA dhe BE: vetëm kështu mund të ndalet shovinizmi serb dhe t'i vjen fundi, e Serbia të çlirohet nga monstra e saj e të demokratizohet mirëfilli, gjë që mbetet një sfidë epokale e popullit serb drejt çlirimit nga tirania e shovinizmit serb.

Njëmend manovrimet nga më të ndryshmet nuk janë tjetër vetëm se taktizime kundrejt Perëndimit për mbrojtjen e vet e të qenit në pushtet, që bëhet në spektrin gjeopolitik të nderë global, por ato duhet të mbahen nën vëzhgim, sepse befas mund të shndërrohen në veprime, me pasoja mbase edhe të pallogaritshme. Nuk është Serbia për ta mbivlerësuar gjithsesi, por as për ta nënçmuar nuk është: në rrethana të caktuar, e duket se ajo po përgatitet në atë drejtim, ajo mund të shndërrohet në një fatkeqësi për shtetet fqinje po se po, por edhe për Bashkimin Evropian e mbase edhe Perëndimin.

## Përdorimi i substancave narkotike në Kosovë, trend në rritje

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Përdorimi i substancave narkotike në Kosovë është trend në rritje, thotë drejtori ekzekutiv i Qendrës për Këshillim të Varësisë "Labyrinth", Safet Blakaj.

Shqetësues, sipas tij, mbetet përdorimi i tyre edhe nga nxënësit, ku u bë thirrje që të ketë bashkëpunim më të madh ndërmjet prindërve, shkollave e institucioneve që të parandalohen raste të tilla.

Blakaj në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se është një rritje e lehtë e përdoruesve të drogave te fëmijët nën moshën 18 vjeç dhe, sipas tij, shkollat duhet të ndërmarrin masa parandaluese. Sipas tij, elementi kryesor i shtimit të përdoruesve është qasja e lehtë në droga. Ai thotë se nxënësit nuk po furnizohen dhe nuk po i përdorin drogat brenda shkollës, por jashtë saj.

Në mesin e konsumuesve të drogës, Blakaj potencoi se janë edhe nëntëvjeçarët, kurse mosha më e rrezikuar është 15-17-vjeçare.

Blakaj ka thënë se fillestarët e drogave konsumojnë llojin e drogës mariuhanë, po ashtu shtoi se 73 për qind të përdoruesve që kanë marrë tretman shëndetësor kanë filluar me marijuanë.



# Pranohen me shkrim dëshmitë e nëntë dëshmitarëve në rastin Thaçi dhe të tjerët

HAGË, 13 SHTATOR - Gjykata Speciale ka njoftuar se më 10 shtator trupi gjykues ka pranuar në prova dëshmitë dhe provat materiale shoqëruese me shkrim të 9 dëshmitarëve në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët. Po ashtu, trupi gjykues ka hedhur poshtë kërkesën në lidhje me dëshmitarin e 10, pa paragjykuar të drejtën e Prokurorisë për të paraqitur kërkesë për ta thirrur dëshmitarin të dëshmojë në sallën e gjyqit.

Veç kësaj, më 5 shtator, trupi gjykues ka miratuar kërkesën e Prokurorisë për të lejuar pranimin në prova të disa pjesëve të dëshmisë me shkrim të një dëshmitari dhe për ta lejuar atë të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës. "Trupi gjykues theksoi se mbrojtja nuk kundërshtoi kërkesën dhe konstatoi se dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës është më e favorshme për mirëqenien e dëshmitarit dhe ndihmon në kryerjen e shpejtë të procesit gjyqësor", thuhet në njoftim.

Të njëjtën ditë, trupi gjykues ka miratuar një kërkesë të Prokurorisë që dhe dy dëshmitarë të tjerë të japin dëshmi nëpërmjet videokonferencës, meqë kjo është më e favorshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Trupi gjykues u bind se dhënia e dëshmisë prej tyre nëpërmjet videokonferencës nuk do t'u shkaktojë dëm të akuzuarve dhe është në përputhje me mbrojtjen e efektshme të të drejtave të tyre. Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënën, 16 shtator, duke filluar në orën 9:00 paradite, raporton "Betimi për Drejtësi".

Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit,



Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuza, ku këta të fundit ngarkohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Më 29 prill 2022 Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, ku pretendohet se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë dhe Semetishtë.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

# Policia sekuestron të holla dhe dokumente në objekte financiare në Leposaviq

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Policia e Kosovës njoftoi të premten se ka sekuestruar miliona dinarë, disa mijëra dollarë, euro dhe franga, si dhe dokumente të ndryshme në dy institucione financiare serbe në Leposaviq, qytet me shumicë serbe në veri të vendit.

Policia tha se të enjten kreu kontrolle dhe bastisje në dy lokacione në Leposaviq pas dyshimeve se institucione financiare kanë bërë shpëlarje parash dhe kanë keqpërdorur autorizimet ekonomike. "Gjatë bastisjes janë sekuestruar; 5.772,313.00 dinarë serbë [rreth 49.300 euro], 57.626,00-



dollarë amerikanë, 10.835,00 euro, 2.790,00 franga zvicerane, dy shtëpiza kompjuteri dhe dy DVR të kamerave të sigurisë", thuhet në njoftim. Ajo tha se ka sekuestruar edhe disa vula dhe dokumente të ndryshme "që dëshmojnë operimin e kundërligjshëm të këtyre institucioneve".

Bastisja e së enjtes lidhet me një aksion të majit të këtij viti në katër komunat me shumicë serbe në veri, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, kur autoritetet e Kosovës i mbyllën gjashtë objekte të Bankës Kursimore të Postës dhe Bankës Popullore të Serbisë.

Edhe gjatë atij aksioni, që autoritetet e Kosovës thanë se kishte të bënte me vendosjen "e rendit dhe ligjshmërisë", ishin konfiskuar prova të ndryshme, përfshirë para.

Këtyre aksioneve të autoriteteve të Kosovës iu parapriu një vendim i Bankës Qendrore e Kosovës për rregulloren e saj të re, e cila nga 1 shkurti ndalon përdorimin e dinarit serb për kryerjen e pagesave.

Rregullorja e BQK-së, që parasheh euron si monedhën e vetme për kryerjen e pagesave, është kundërshtuar fuqishëm nga Serbia.

Serbia ndan ndihmë në vlerë të miliona eurove për serbët në Kosovë, të cilëve ua paguan rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë, në valutën serbe, dinar.

BQK-ja i licencoi në maj tetë degë të institucioneve financiare në komunat me shumicë serbe, në Leposaviq, Zveçan, Graçanicë, Shtërpcë dhe një në Shillovë të Gjilanit.

Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Kosovës ta shtyjë zbatimin e rregullores së BQK-së, duke u thirrur në ndikimin që mund të ketë te komuniteti serb në Kosovë, që pranon pagesa të ndryshme në dinarë nga buxheti i Serbisë.

## FSK-ja realizon me sukses ushtrimin fushor "Steel 01"

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Komanda e Forcave Tokësore (KFT), Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë (R2K), në kuadër të ngritjes së kapaciteteve luftarake dhe përgatitjeve për validimin e regjimentit të dytë, ka realizuar me sukses ushtrimin fushor "Steel 01" në poligonin e stërvitjes ushtarake në Babaj të Bokës dhe Deve. Qëllimi i ushtrimit ishte testimi i procedurave standarde operative të kompanive të regjimentit gjatë realizimit të operacioneve luftarake për përmbushje të detyrave operacionale bazuar në misionin e KTF-së.



# Pse CEFTA është e rëndësishme për Kosovën?

Zyrtarë të lartë gjermanë, të angazhuar për Ballkanin, kanë paralajmëruar se Kosova mund të përjashtohet nga nismat rajonale tregtare nëse vazhdon të ngulë këmbë në ndalesën që zbaton ndaj importit të mallrave nga Serbia dhe, rrjedhimisht, siç vlerësojnë ata, shkel parimet e CEFTA-s. Çfarë është ajo, dhe çfarë ka përfituar vendi ndër vite prej saj?



**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - "Nga një industri e brishtë dhe relativisht e pazhvilluar prodhuese, Kosova sot është burim i produkteve cilësore, të cilat plasohen jo vetëm në tregjet e vendeve të CEFTA-s, por edhe më gjerë, në Bashkimin Evropian, në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera".

Kështu shprehet Arian Zeka, kryetar i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, sipas të cilit, të qenët pjesë e Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), i ka ndihmuar Kosovës ta përmirësojë cilësinë e prodhimeve.

Palë të Marrëveshjes, e cila synon rritjen e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, eliminimin e barrierave tregtare mes palëve dhe tërheqjen e investimeve, janë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, plus Moldavia, që prej vitit 2006.

Nënshkrueset e mëparshme dhe themeluese të CEFTA-s janë larguar prej saj, pas anëtarësimit të tyre në BE. Zbatimi i Marrëveshjes është parakusht edhe për vendet e tjera që synojnë integrimin në bllokun evropian.

## Si u aktualizua CEFTA?

Emri i saj është përmendur shpesh ditët e fundit, pas kërkesës që iu bë Kosovës nga i dërguari i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, për heqje të ndalesës ndaj mallrave të prodhuara në Serbi, sepse një gjë e tillë është kundër parimeve të CEFTA-s.

Në këmbim, diplomati gjerman ka ofruar që Kosova të përfaqësohet në CEFTA me emrin e saj, me fusnotë, dhe jo përmes Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është bindur.

Qeveria e Kosovës i ka ndaluar importet nga Serbia në qershor të 2023-s, me arsyetimin se ato po rrezikojnë sigurinë e Kosovës dhe se, përmes tyre, mund të hyjnë edhe armë në vend. Megjithatë, autoritetet e Kosovës nuk kanë dalë asnjëherë me ndonjë raport vlerësues se si ka ndikuar kjo masë në nivelin e sigurisë.

Për Zekën kjo masë ka goditur interesat komerciale të partnerëve të Kosovës. "E kemi konsideruar masë paradoksale, duke marrë parasysh që të njëjtën kohë vijon importi i gjysmëprodukteve dhe lëndëve të para ndërsa, në anën tjetër, mallrat përfundimtare, të cilat në masë të madhe prodhohen nga ndërmarrjet që janë në pronësi të huaj në Serbi - po flasim për kapital amerikan dhe kapital evropian - nuk lejohet të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës", konsideron Zeka.

Ai, po ashtu, thotë se përfitimet e Kosovës nga CEFTA janë shumëdimensionale, teksa përmend: përmirësimin e ofertës, ose rritjen e atraktivitetit të Kosovës në sytë e investitorëve të huaj; ndjekjen e reformave ekonomike; ndryshimin radikal në strukturën e eksporteve, në llojet e produkteve dhe në llojet e mallrave.

Si Zeka, ashtu edhe Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, thonë për Radion Evropa e Lirë se Kosova duhet ta shfuqizojë sa më shpejt ndalesën për importet nga Serbia.

"Kosova duhet t'i heqë këto masa dhe duhet të sillet si një aktore kryesore, si një aktore e rëndësishme dhe e drejtë, dhe e besueshme në tregtinë e përbashkët rajonale", shprehet Rashiti.

Në vend të ndalesës, Zeka e Rashiti besojnë se Kosova duhet t'i shfrytëzojë mekanizmat ligjorë të paraparë nga CEFTA, për t'u ankuar për barrierat tregtare që i vendosen asaj nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Për ndalimin e importeve nga Serbia, Kosova është kritikuar edhe në raportin e sivjetmë të Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e të bërit biznes në Kosovë. Aty është thënë se "ndalesa ka shkaktuar konfuzion të madh tek importuesit dhe ka ndikuar negativisht te kompanitë në pronësi të subjekteve të huaja në Kosovë për shkak të ndërprerjes në zinxhirin e furnizimit".

Në Raportin e Progresit për Kosovën, për vitin 2023, Komisioni Evropian ka thënë se ndalesa është në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që përbën marrëveshjen e vetme kontraktuale të Kosovës me BE-në.

## Pse kërkesa po përsëritet tash?

Rashiti beson se insistimi gjerman qëndron te përgatitjet për takimin e radhës në kuadër të Procesit të Berlinit - platformë formale e politikës së BE-së ndaj rajonit të Ballkanit - dhe për marrëveshjet e reja rajonale që synohet të arrihen aty.

Procesi i Berlinit ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e rajonit dhe në përgatitjen e tij për anëtarësim në bllokun evropian.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka paralajmëruar se nëse është e nevojshme, vendet e Ballkanit do të ecin përpara drejt bashkëpunimit rajonal edhe pa Kosovën.

Rashiti thotë se këtë skenar e dëshirojnë disa vende të Ballkanit - Serbia, Bosnja dhe disa elementë brenda Malit të Zi - andaj Kosova nuk duhet të lejojë diçka të tillë. "Procesi i Berlinit dhe të gjitha organizatat që kanë rrjedhur nga ai, apo i janë bashkuar rolit të Procesit të Berlinit, janë i vetmi instrument ku Kosova ulet e barabartë me vendet e tjera. Kosova duhet, me çdo kusht, të bëjë më të mirën për ta ruajtur vendin e saj dhe për t'i shtyrë agjendat e saj", vlerëson Rashiti.

Për më shumë, sipas tij, ndonjë dështim eventual i Procesit të Berlinit ndihmon në shfaqjen apo ringjalljen e iniciativave të tjera, si Ballkani i Hapur, që është kundërshtuar vazhdimisht nga Kosova.

Zeka frikësohet për "pasoja të paparashikuara" nga një izolim i tillë ekonomiko-politik i Kosovës, por nuk sheh gatishmëri të qeverisë për heqje të bllokadës, duke marrë parasysh se zgjedhjet e ardhshme janë afër.

## Hajdari thotë se ka mbështetje për bizneset që fokusohen në prodhimin e gjelbër




**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se mbështetja është e madhe ndaj bizneseve që në fokus kanë prodhimin e gjelbër.

Sipas saj, ndryshimet klimatike kanë ndikuar fuqishëm industrinë prodhuese, ndërsa inovacioni në sektorin prodhues pritet të luajë një rol të madh.

Në konferencën Ndërkombëtare për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Ndryshimet Klimatike, me temën "Inovacioni për një të nesërme të qëndrueshme: akademia, industria dhe qeveria në dialog", Hajdari ka thënë se 33 milionë euro është kostoja për ndërtimin e parqeve industriale dhe teknologjike. "Është një nder i madh të jem pjesë e kësaj konference, një platformë kaq e rëndësishme për ndarjen e ideve dhe praktikave për një të ardhme më të mirë. Kjo përfaqëson një moment kritik në planetin tonë për t'i adresuar sfidat klimatike. Kjo më shumë se kurrë duhet t'i bashkojmë forcat përmes dialogut të hapur përmes qeverisë dhe akademisë dhe kalimit drejt një ekonomie të gjelbër. Një nga këto politika është edhe politika industriale me vizion deri në vitin 2030 duke pasur prioritet zhvillimin ekonomik. Ne si ministri kemi hartuar një strategji ambiogjioze në mbështetjen e bizneseve, kemi përgatitur një plan gjithëpërfshirëse në nëntë sektorë", është shprehur ajo.

INTERVISTË ME POETIN NIELS HAV / *Phenomenal Literature*[1]

# Vdekja është tabu

**Më thuaj, si e shikoni poezinë në jetën e përditshme?**
Të mos kemi pretendime, jeta është një cirk brutal, shpesh jemi të rrethuar nga katastrofa më të mëdha ose më të vogla. S'ka nevojë ta dekorojmë këtë me poezi dhe metafora. Ne të gjithë luftojmë kundër çmendurisë së zakonshme që kërcënon të pushtojë jetët tona dhe të përmbysë universin, ndërkohë që lumturia shkon dorë për dorë me brengën dhe mjerimin, monstrat brejnë vazhdimisht derën e qilarit dhe fëmijët vallëzojnë nëpër rrugë me pritshmëri të forta. Këto elemente janë kushtet normale për poezinë. Ja ku jemi, ky është dheu ku rritet poezia.

**Çfarë mendoni se duhet të jetë qëndrimi i poetit për problemet sociale, luftën, mjedisin, varfërinë, ekonominë etj.?**
Të shërbyerit është kundër natyrës së poezisë. Ky nuk është obligim, por poeti natyrisht duhet të jetë i përfshirë në problemet aktuale për aq shumë sa mundet, si të gjithë qytetarët e tjerë. Nëse shkrimtari dëshiron gjithashtu të përfshijë edhe poezinë e tij, kjo varet nga fokusi, talenti dhe mundësitë. Letërsia kurrë nuk mund të jetë agjitacion, në thelbin e saj poezia refuzon çdo kapje për fyti. Poezia para së gjithash duhet të jetë art, kjo është një çështje për jetë a vdekje. Por pastaj në poezinë e mirë mbi çdo lloj teme gjithmonë do të ketë nënrryma humanizuese – të shprehura ose të nënkuptuara – një angazhim kundër shfrytëzimit social, dhunës dhe të gjitha llojeve të së keqes politike apo shkatërrimit të natyrës dhe planetit.

**Çfarë mendoni për kultin aktual të shëndetit dhe trupit që paragjykon njerëzit të cilët kanë preferencat dhe zakonet e tyre në botë? Cigaret, alkooli etj.**
Vdekja është tabu. Shëndeti fizik duket të jetë feja zyrtare me trupin si një tempull për adhurim. Shpresa për një nirvana tokësore dhe një lumturi të përjetshme është një iluzion laik. Një fantazi e brishtë, ja pse misionarët duhet të jenë kaq fanatikë. Le të bashkëjetojmë me to dhe të shpresojmë se asketizmi dhe heqja dorë nga dëshirat personale dhurojnë jetë të amëshuar. Fatkeqësisht, kam frikë se jemi të gjithë në një mision vetëvrasës.

**Si mund ta zbulojmë që dikush e ka këtë "sëmundje të lemerishme" siç e kanë quajtur poezinë? Cilët janë simptomat që e karakterizojnë?**
Disa nga miqtë e mi janë shumë të tronditur rreth këtij formulimi, jo të gjithë poetët janë të pajisur me një sens humori. Por fakt është që pasioni ynë për poezinë është një neveri e tmerrshme, ne e kalojmë kohën duke gjuajtur fjalë – shpesh unë neglizhoj të bërit e gjërave më të dobishme me qëllim që të vras mendjen për misteret e jetës, me shpresën e kapjes së një mendimi apo artikulimi në fluturim. Simptomat janë të shumta, ne jemi antisocialë, dhe shpesh ndërmjet një vështrimi të hutuar dhe aktiviteti të ethshëm. Pak vetëironi është e nevojshme.

**A besoni se poezia duhet të përqendrohet tani më shumë në jetën e përditshme, duke lënë abstraksionin e ideve të mëdha?**
Çdo poet duhet të gjejë rrugën e vet në rrjedhë dhe ai që shkruan për çfarë i ndodh atij natyrisht në rrjedhën e jetës së përditshme kaotike, është në gjurmë të mira. Detyra e poezisë është jeta e përditshme por unë nuk besoj se poezia duhet të heqë dorë nga ndonjë gjë dhe kuptueshëm idetë e mëdha janë të nevojshme për të na udhëzuar në këtë epokë të konfuzionit elementar. Çfarë s'më pëlqen është kur poezia noton në sentimentalizëm abstrakt konvencional pa kontakt me realitetet e luftës për jetesë të njerëzve të zakonshëm. Liricizmi personal dhe emocionalizmi i pakontrolluar shpesh rrezikon ta mbysë poezinë.

**Çfarë mendoni për rolin e institucioneve shtetërore në zhvillimin e kulturës, roli i shtetit për shkrimtarin dhe i shkrimtarit për shtetin?**
Është e shëndetshme për poezinë- por mbase jo për poetin- të qëndrojë në opozitë ndaj institucioneve politike dhe atyre në pushtet. Disa regjime e keqkuptojnë gjendjen dhe iu ofrojnë poetëve dhomë falas dhe ushqim në burg. Shumë bujare dhe plotësisht idioteske. Është detyra e poezisë të jetë kritike ndaj qeverisë dhe detyra e shtetit të mbështesë dhe mbrojë artin dhe kulturën, financiarisht dhe në çdo mënyrë të mundshme. Një shoqëri e shëndetshme ka nevojë për një dialog kritik. Udhëheqësit dhe politikanët e mençur e kuptojnë këtë. Kur libri "Les Fleurs du Mal" (Lulet e së Keqes) u botua, Sharl Bodler u zvarrit në gjykata dhe u akuzua për imoralitet dhe blasfemi. Kush ishte perandor apo president i Francës në atë kohë? Askush nuk e mban mend, politikanët rrëshqasin prapë në zonën e hijes ndërkohë që libri i Bodler qëndron si një kryevepër.

**Ç'mendoni për kontributin e promovimit të kulturës në përmirësimin e një kombi?**
Arti nuk duhet të mbështetet vetëm në një nivel kombëtar por edhe qytetet, rajonet dhe bashkitë duhet të kontribuojnë në mbështetjen e artit dhe kulturës. Biblioteka të mira publike, salla koncertesh, teatro, galeri arti, dhe të gjitha institucionet e tjera arsimore me radhë, janë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Kjo i forcon komunitetet dhe kontribuon në një klimë biznesi të shëndetshme dhe tërheqëse dhe



kështu qytetet, rajonet dhe kombet do të lulëzojnë. Kultura është një investim i mirë. Gabriel Garsia Markez ndoshta kontribuon më shumë për GNP (prodhimin e brendshëm bruto), për lumturinë dhe mirëqenien në Kolumbi sesa shumica e lordëve të drogës.

**Cilët autorë ju kanë ndikuar?**
Një prej poetëve të parë që ka pasur ndikim tek unë ishte Pablo Neruda. Kur isha adoleshent, pashë një program portretizues me të në televizion dhe u godita nga një ëndërr ngacmuese. Doja të bëhesha poet. Biseda jonë këtu më kujton rëndësinë e Nerudas në trurin tim të ngatërruar, ai është një mik i vjetër i njohur. Mjeshtër i madh, ai është unik. Në të njëjtën kohë, ndesha Dostojevskin në një libër shkolle. Por janë dyzina autorësh të tjertë që kanë ndikuar tek unë, çmoj Tomas Transtromer, Cezlav Milosh, dhe Elizabet Bishop dhe nëse duhet të përmend disa emra danezë, ata mund të jenë Per Hojholt dhe Peter Seeberg.

**A keni lexuar ndonjë autor kolumbian? A i vlerësoni autorët e gjuhës spanjolle? A keni lexuar ndonjë autor bashkëkohor?**
Letërsia e Amerikës së Jugut shpesh vjen në Danimarkë me vonesë. Aktualisht po lexoj me kënaqësi romanin e fundit të Roberto Bolanos: "2666". Kam lexuar disa prej poezive të tij të cilat gjithashtu i pëlqej. Kam një të metë që nuk jam në gjendje të lexoj spanjisht, është sporadike ajo që di nga shkrimtarët e kohëve të fundit. Ndërmjet klasikëve, çmoj Cesar Valejo, dhe Borgesin natyrisht. Kam shkruar një poezi për këtë të fundit dhe Xhojsin e cila huazon titullin nga Borgesi: Në verbërinë e Tij.
Kujtoj Markezin. Gjithashtu Oktavio Paz, Albertin, Aleiksander dhe shumë të tjerë. Të mos harrojmë Julio Kortazar, për të cilin Neruda thotë: "Çdokush që nuk e lexon Kortazar është i paracaktuar të dështojë. Të mos e lexosh atë është një sëmundje e rëndë, e padukshme e cila në kohë mund të ketë pasoja të tmerrshme. Diçka e ngjashme me një njeri që nuk ka shijuar kurrë pjeshkën. Ai do të bëhet në heshtje më i trishtuar dhe ndoshta pak nga pak, do të fillojnë t'i bien flokët." Fatkeqësisht pak është përkthyer Kortazar në danisht, ne jemi në zonën e riskut për të humbur flokët.

**Cila është një prej fjalëve në danisht që e preferoni? (Lutem jep kuptimin në anglisht të fjalës dhe na thuaj për të)**
Lëkundem ndërmjet fjalëve ømhed dhe sødme. Le të zgjedh sødme. Nuk është vetëm ëmbëlsia por që dikush ose diçka është duke të hyrë në zemër apo prekur me personalitetin, sjelljen apo pamjen- gjithashtu do të thotë një shije apo aromë e ëmbël. E çmoj kur njerëzit e kanë këtë cilësi.

**Ka një paragjykim që i konsideron nordikët si pak të shprehur lidhur me afeksionin ndërpersonal. Çfarë mund të na thuash për këtë?**
Si të gjithë paragjykimet, kjo ndoshta ka një të vërtetë të tmerrshme që përpiqemi ta heqim qafe por digjet brenda të gjithë skandinavëve- prapa një fasade të ftohtë- ka një zjarr të nxehtë që ulërin. Kështu që ki kujdes mos digj buzët, të lutem.
Në një shoqëri si juaja, në të cilën ka një përputhje mes shtetit dhe njerëzve, ku niveli i kulturës është nga më të lartat, një shoqëri qytetare dhe paqësore, ju si poet çfarë do të kritikonit për këtë sistem?
Tashmë edhe Shekspiri ishte i vetëdijshëm për të, diçka është kalbur në shtetin e Danimarkës. Dhe ende sot, jo çdo gjë është e përkryer. Së bashku me Bashkimin Evropian dhe pjesën tjetër të botës, jemi në mes të krize, administrata jonë aktuale ka një tendencë për t'ia shitur faturën të dobëtit dhe të varfërit dhe të transferojë fitimet tek të pasurit. Një Robin Hud i kundërt. Aktualisht ka një orvatje të pështirë për të minimizuar emigracionin e refugjatëve nga pjesët më të paprivilegjuara të botës.

**Çfarë mendimi keni se një nga karakteret kryesore në veprat e Shekspirit dhe të gjithë letërsisë ishte një princ danez i quajtur Hamlet?**
Një pyetje interesante. Shekspiri kishte një aftësi fabuloze për të gjetur lëndë për tragjeditë e mëdha dhe për të shprehur emocionet njerëzore me fjalë të thjeshta dhe të thella. Ai mund të ketë takuar danezë në Londër që i kanë treguar atij për princin mistik. Çmenduria e Hamletit dhe melankolia e Ofelisë- mbase mishërojnë veçoritë esenciale daneze por njerëzit kudo në planet gjejnë aspekte të vetes së tyre në këto karaktere. Jemi të gjithë të mbërthyer nga këto dilema të paepura: "Të jesh a të mos jesh, kjo është çështja".
Në vendet e Amerikës Jugore, po marrim si rast Kolumbinë, ka një lexim prej 1.6 librash në vit për person, një shifër minimale krahasuar për shembull me leximet vjetore në vendet nordike. Megjithë këto tregues, ne kemi lexuesit dhe poetët tanë këtu, Kujt do t'ía atribuonit këtë që në këto shoqëri të varfra pavarësisht nga këta tregues, ekzistojnë lexuesit dhe poetët?
E di që realiteti kolumbian është i komplikuar dhe prapë ju keni lexues entuziastë dhe poetë të fortë që punojnë intensivisht për ta rishpikur poezinë dhe ridefinuar identitetin kulturor të Kolumbisë. Kam respekt për këtë. Shpresoj se qeveria juaj do të gjejë mënyrat për të mbështetur këto synime, veçanërisht në kombet me një poezi të tillë të pasur dhe diverse që mbase mund të përbëjnë një fenomen unik. Shpresoj që në të ardhmen të kem mundësinë të mësoj më shumë për poezinë kolumbiane. Ky kontinent ka një rëndësi në rritje në ekonominë globale, dhe letërsia e Amerikës Jugore mund të ketë shumë për të ofruar në vitet e ardhshme.

**Në vende si juaji, ku shteti subvencionon njerëzit që i janë kushtuar letërsisë, dhe shkrimtarët marrin pensione, kultura është një alternativë. Kolumbia nuk ka diçka të tillë. Si do t'í inkurajonit të rinjtë që dëshirojnë të shkruajnë poezi në këto vende?**
Mbase këshilla më e mirë për t'í dhënë një shkrimtari të ri në këto rrethana do të ishte të kryente vetëvrasje. Shumë prej nesh ndoshta e kanë konsideruar këtë mundësi por kanë ngurruar paksa. Një këshillë e imja: prit pak. Dil për një shëtitje, luaj me fëmijët, tako miqtë, puth kur të vijë shansi. Për më tepër, shkruaj, shkruaj, shkruaj më të mirën që mundesh. Mbase do të ndodhë një mrekulli që e gjitha kjo të mos shkojë më kot. Në çdo rast, kjo është e gjitha që mund të bëjmë. Le të përgjigjem me një poezi:

**Nxitje**
A nuk është një mendim shpresëdhënës
Që brenda disa dekadave, ne
Dhe e gjithë kjo epokë konfuze
Me presidentët e saj cinikë
Argumentet e bjerra
Prezantueset e spitulluara të televizionit, gazetarët mediokër
Dhe i gjithë kori jubilar kapitalist
Të ikin,
Për të gjithë kohën!
Ne do të zhdukemi
Ata do të zhduken
Unë do të zhdukem
Ju do të zhdukeni
Do të zhduket gjithçka
Urra!

**/Gazeta "ExLibris" / Përktheu: Kujtim Morina /**




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Hendbolli rikthehet me derbi

Prishtinë, 13 shtator - Të shtunën janë ndeshjet e para në edicionin 2024/2025 në Superligën e Kosovës në hendboll. Gara që pritet të jetë shumë interesante hapet me superderbi. Kampionati fillon në Superligën e hendbollistëve dhe në atë të hendbollisteve, ndërsa në të dy konkurrencat është nga një derbi i madh në xhiron e parë. Te hendbollistet të dielën nga ora 18:00 është takimi Ferizaj - Istogu. Këto dy skuadra u takuan para një jave në ndeshjen për Superkupë. Fitore me penallti shënoi Ferizaj. Istogu është kampion i Kosovës, derisa Ferizaj ka fituar Kupën e Kosovës në edicionin e kaluar. Te hendbollistët të hënën nga ora 20:00 është derbi i madh në mes të Besa Famgasit dhe Rahovecit. Rahoveci është kampion, kurse e fitoi Superkupën para një jave. Besa në edicionin e kaluar ishte nënkampione, por ka pretendime ta kthejë titullin e kampionit.



# Superliga rikthehet me dy derbi

Vëmendja e sportdashësve në Kosovë, pas ndeshjeve të Përfaqësueses në Ligën e Kombeve, do të jetë në Suharekë dhe Podujevë. Në këto dy qytete do të përballen top skuadrat elitare Ballkani - Prishtina dhe Llapi - Drita

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 13 shtator - Pas ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në Ligën e Kombeve ndaj Rumanisë (0-3) dhe Qipros (0-4), këtë fundjavë rikthehet Superliga e Kosovës me ndeshje mjaft interesante. Xhiroja e pestë zhvillohet përgjatë tri ditëve nga ora 15:00. Dy superderbi zhvillohen në këtë xhiro, ku fillimisht të shtunën në Suharekë kampionët e Ballkanit e presin Prishtinën. Të dyja këto skuadra kanë pikë të barabarta, por kryeqytetasit kanë një ndeshje më pak të zhvilluar. Kampionët në fuqi, pas humbjes nga Malisheva, do të tentojnë t'u rikthehen fitoreve dhe tash me trajnerin e ri Artim Pollozhani, i cili e zëvendëson të larguarin Ilir Daja. Të shtunën zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Ferizajt dhe Suharekës. Suharekasit e kanë nisur mirë edicionin e parë në elitë ku nga tri ndeshje ka grumbulluar shtatë pikë, derisa Ferizaj ka katër pikë në katër ndeshje dhe tash do të mund ta regjistrojë fitoren e dytë në këtë kampionat. Synime të mëdha ka edhe skuadra e Suharekës që ka një organizim të mirë dhe synon rezultate sa më të mira në Superligë. Të dielën zhvillohet derbi i dytë i xhiros në mes të Llapit dhe Dritës në stadiumin "Zahir Pajaziti". Llapi nuk e ka nisur në mënyrën më të mirë kampionatin, pasi nga katër ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar vetëm një fitore, dy humbje dhe një barazim. Tash llapjanët do ta kërkojnë fitoren në një ndeshje të madhe për të pasur motiv për ndeshjet e radhës. Drita e ka zhvilluar vetëm një ndeshje dhe e ka fituar në elitë, pasi ndeshjet e tjera janë shtyrë për shkak të angazhimit në arenën ndërkombëtare. Dukagjini - Malisheva është ndeshja tjetër në program për ditën e diel. Klubi nga Klina i humbi dy ndeshjet e para, por më pas i fitoi dy të tjerat dhe tash e synon fitoren e tretë radhazi. Malisheva, e motivuar pas fitoreve ndaj Ballkanit dhe Llapit, e synon të njëjtën gjë edhe ndaj Dukagjinit. Të hënën mbyllet java e pestë me ndeshjen Gjilani - Feronikeli '74. Të dy këto klube janë në fundin e tabelës dhe kërkojnë rezultat pozitiv.



**SUPERLIGA - Java e pestë**

**Të shtunën takohen:**
15:00 Ballkani - Prishtina
15:00 Ferizaj - Suhareka

**Të dielën takohen:**
15:00 Llapi - Drita
15:00 Dukagjini - Malisheva

**Të hënën takohen:**
15:00 Gjilani - Feronikeli 74

# Asllani: Fanella e Kosovës sjell kënaqësi, familjen e bëra krenare

Prishtinë, 13 shtator - Fisnik Asllani, talenti i ri nga Bundesliga 2, i cili luan për SV Elversberg, debutoi për herë të parë me Kombëtaren e Kosovës në ndeshjen kundër Rumanisë. Ndonëse rezultati në këtë ndeshje ishte zhgënjyes për të gjithë, debutimi i tij në fanellën dardane shënon një hap të rëndësishëm në karrierën e tij, teksa pritet që me kalimin e viteve ai të bëhet një nga sulmuesit kryesorë të Kosovës. Në një intervistë për "futbolli.info", Asllani ndau përvojën e tij të parë me fanellën dardane dhe atmosferën në ekipin kombëtar. I pyetur për pritjen nga bashkëlojtarët dhe stafi teknik, Asllani u shpreh: "Lojtarët dhe stafi më pritën në mënyrë shumë të mirë. Mikpritja e tyre më bëri të ndihem shumë komod si në shtëpinë time".



Asllani foli edhe për atmosferën në kampin e Kosovës, duke theksuar energjinë e fortë pozitive që mbizotëronte gjatë stërvitjeve dhe gjatë kampit. "Atmosfera në kampin e Kosovës ishte shumë e mirë. Energjia pozitive dhe puna ishin ato që mbizotëronin gjatë gjithë kohës. Kjo atmosferë na shtonte motivimin për të dhënë më të mirën për vendin dhe fanellën e shenjtë", ka shtuar ai. Debutimi me fanellën e Kosovës ishte një moment i paharrueshëm për Fisnik Asllanin. Për të ky ishte një moment për t'u krenuar, sidomos duke pasur parasysh mbështetjen e familjes së tij. "Ta veshësh fanellën e Kosovës ishte një ndjenjë e veçantë. Kam ndier shumë kënaqësi që e kam bërë familjen time krenare. Ata ishin të pranishëm në stadium, së bashku me të tjerët, duke na përkrahur si ekip", ka thënë Asllani.
Në fund, Fisniku dërgoi edhe një mesazh të fuqishëm për të gjithë futbollistët që të bëhen pjesë e Kombëtares së Kosovës. "Mesazhi im është që të gjithë të bashkohen me ekipin kombëtar të Kosovës, sepse jemi një brez shumë i mirë. Kemi lojtarë me përvojë nga të cilët mund të mësojmë shumë, si dhe të rinj të talentuar nga të cilët pritet shumë. Ne duhet të jemi konsistentë në punë dhe të mos ndalemi kurrë. Ta ruajmë gjithmonë disiplinën për t'i arritur ëndrrat tona të përbashkëta", ka deklaruar ai.
Fisnik Asllani është një futbollist premtues për të ardhmen e Kombëtares së Kosovës dhe me përkushtimin dhe talentin e tij, pritet ta vazhdojë rrugën e sukseseve dhe të lë gjurmë në arenën ndërkombëtare.

## UEFA ua beson katër gjyqtareve shqiptare ndarjen e drejtësisë në ndeshjen Sporting - Real Madrid

Tiranë, 13 shtator - Federata e Futbollit e Shqipërisë (FSHF) përmes një njoftimi në rrjetet sociale ka bërë me dije se katër gjyqtare shqiptare janë caktuar për ta ndarë drejtësinë në duelin e femrave mes Sporting Lisbonës dhe Real Madridit në Ligën e Kampionëve. Ky takim i është besuar gjyqtares Emanuela Rusta, e cila do të ndihmohet nga treshja e saj që përbëhet nga Erinda Kume, Mirjeta Salla dhe Eglantina Pjetrushaj. Kjo nuk është hera e parë që UEFA ua ka besuar gjyqtareve shqiptare një ndeshje të rëndësisë së tillë pasi kohë më parë pikërisht Rusta kishte ndarë drejtësinë në ndeshjen e femrave në mes të Benficës dhe Barcelonës. Duke marrë parasysh profesionalizmin e tyre të lartë, UEFA gjithashtu kishte marrë vendim që gjyqtaret shqiptare ta ndajnë drejtësinë në një ndeshje kualifikuese për Kampionat Evropian. Rusta kohë më parë kishte ndarë drejtësinë në ndeshjen e grupmoshave U19 të vajzave në mes të Holandës dhe Francës. Kujtojmë se ndeshja në mes të Sportingut dhe Real Madridit do të luhet më 19 shtator (e enjte) me fillim nga ora 17:00.



## Berisha, Çekiçi, Veseli dhe Dermaku janë futbollistë të lirë

Tiranë, 13 shtator - Në shumicën e kampionateve, dritarja e transferimeve është mbyllur, por për ata futbollistë të cilët janë të lirë, ka ende kohë. Pasi disa kuqezinj ndryshuan skuadër këtë verë, si Tomas Strakosha, Armando Broja, Nedim Bajrami, Taulant Seferi, Marvin Çuni apo Marash Kumbulla, ka ende lojtarë të Kombëtares të cilët kërkojnë një sistemim. Për momentin, pas largimit nga Empoli, portieri Etrit Berisha nuk ka gjetur një skuadër për ta vijuar karrierën. E njëjta situatë edhe për Endri Çekiçin. Pasi prishi kontratën me klubin turk të Pendiksorit, mesfushori nuk ka firmosur ende me një ekip të ri. Teksa Frederik Veseli është shumë pranë Dinamos në Superiore, një mbrojtës tjetër si Kastriot Dermaku është një futbollist i lirë pas largimit nga Lecce.



# Ademi kujton periudhën e pavarësimit të futbollit nga regjimi i atëhershëm serbosllav

**Prishtinë, 13 shtator** - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se sot shënojmë një ditë historike për futbollin e Kosovës, ditën kur u zhvillua ndeshja e parë e mëvetësimit të futbollit tonë, ndërmjet Flamurtarit dhe Prishtinës, organizuar nga Federata e Pavarur e Futbollit të Kosovës, më 13 shtator të vitit 1991. "Ky njihet njëherësh si fillimi i periudhës së pavarësimit të futbollit nga regjimi i atëhershëm serbosllav, me ç'rast ishte themeluar FFK-ja e pavarur, nën drejtimin e kryetarit Agim Bytyqi. Për të realizuar këtë nismë madhore dhe për të vënë në funksion federatën, u krijua një sistem i garave të reja dhe u zhvillua ndeshjen e parë historike", ka shkruar Ademi në rrjetet sociale.



Ai ka thënë se klubet u organizuan falë shpirtit sportiv dhe mbështetjes së donatorëve të palodhur, ndërsa të gjitha organet e nevojshme u themeluan për funksionimin e ligës. "Për shkak të përjashtimit nga objektet sportive nga regjimi serb, u improvizuan fusha të reja futbolli, duke rifilluar garat edhe në kushte të vështira. Sot me krenari përkujtojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe bashkëkohanikët që kontribuuan në ato kohë: lojtarët, trajnerët, drejtuesit dhe donatorët e klubeve, gjyqtarët dhe delegatët". "Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që ofruan tokat e tyre për t'i kthyer në fusha futbolli. Këto fusha, që sot mund të jenë të ndërtuara apo toka të punuara, ishin dhe do të mbeten një pjesë e shenjtë e historisë së futbollit kosovar. Urime të gjithë atyre që janë ende mesin tonë e përkujtim i përjetshëm për ata që nuk janë më, por që dhanë kontributin e tyre që futbolli kosovar të këtë vazhdimësi edhe në kushte të vështira okupimi!", ka shkruar presidenti Ademi.

# Leclerc thumbon Neweyn: Do t'i tregojmë se bëri gabim që nuk erdhi te Ferrari

**Baku, 13 shtator** - Zyrtarizimi i lëvizjes së Adrian Newey tek Aston Martini është padyshim ndër temat kryesore të diskutimit këtë fundjavë në Baku, ku do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Azerbajxhanit në Formula 1. Fillimisht u përfol për një kalim te Ferrari, me të cilin pati bisedime, por negociatat rezultuan të pasuksesshme. Charles Leclerc nuk u fsheh pas asnjë komenti dhe foli hapur me gazetarët për çështjen e Newey. "Nuk kemi asnjë zhgënjim. E di që folëm me Adrian, por më pas ai mori vendimin e tij dhe unë e respektoj atë. Ai mendonte se Aston Martin ishte më i mirë, ndërsa për mua Ferrari mbetet numri 1", ka thënë Leclerc. "Më vjen keq për Adrian, por besoj shumë më tepër te puna në grup sesa te një person të vetëm", ka




